## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhurnar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | Komuna e Kamenicës | 600535390 | / / / | | SKËNDERBEU | 1/1 | | 20.01.2021 |

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 14963
Nr. i faq. Br. str. 2 Data: Datum: 10/05 2024
KAMENICË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 10.05.2024**

Bazuar në nenin 11, 12, dhe 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr.28 Publikuar më 4 qershor 2008), nenin 6, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, neni 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe neni 14 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, nenit 6 paragrafi 3, neni 8 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 3 paragrafi 3.7, neni 5 paragrafi 5.1 shkronja h) neni 70 paragrafi 70.1 shkronja h) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 29.04.2024 miratoi këtë:

# VENDIM
# PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE PËRMES ANKANDIT PUBLIK

1. Me këtë Vendim, propozohet dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtëshme të Komunës së Kamenicës, në shfrytëzim afatshkurtër përsonave fizik dhe juridik si në vijim:

   **1.1.** Njësia kadastrale me nr. P-71107041-01985-0, vendi i quajtur, Qendra Tregtare Zejtare me sipërfaqe prej 6208 m$^2$, në zonën kadastrale në Kamenicë, Komuna e Kamenicës.

2. Nga Parcela e cekur në pikën **1.1** të këtij Vendimi, jepen në shfrytëzim S - 85 m$^2$.

3. Afati kohorë për dhënien në shfrytëzim të pronës së palujtshme Komunale është afatshkurtër me kohëzgjatje prej 15 vite.

4. Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës që të zhvilloj procedurat për shpalljen e Ankandit, si dhe Drejtoria për Pronë Gjeodezi dhe Kadastër të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimin e kontratës pas lidhjes së sajë.

5. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës Komunale është Interesi Publik dhe përfitimi ekonomik i Komunës nga prona Komunale (përfitimi material - qiraja).

6. Procedurat për dhënien e pronës së palujtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër realizohet përmes ankandit publik, në harmoni me Ligjin Nr.06/L092, Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Kembim të Prones së Palujtshme të Komunës.

7. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së palujtshëme do të përcaktohen me kontratë e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfitusit të marrjes në shfrytëzim të pronës së palujtshme në periudhë afatshkurtër.

8. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë përkatëse.

9. Ky Vendim hyn në fuqi (7) shtatë ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Kamenicës.

***Vendimi t'i dërgohet**: Zyrës së Kryetarit,Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, MAPL-së dhe QSHQ- arkiv.*

Elridon KASTRATI

Kryesues i Kuvendit të Kamenicës

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 12663
Nr. i faq. Br. str. 4 Data Datum: 22/04 2024
KAMENICË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

KOMUNA E KAMENICËS
Drejtoria për i Kadastër , Gjeodezi dhe Pronësi

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Sh.07. Nr. 02-07-045/2024. | | |
| Referenc-ë: | | | Kryesuesin e Kuvendit Komunal | | |
| Për/Za/To: | | | Liridon Kastrati | | |
| | | | Drejtor e DPKGJ-së Diana Ajvazi | | |
| CC: | | | DPKGJ-së Z. L shef ;Fadil Hoti | | |
| Nga/Od/From: | | | Informatë | | |
| Tema/Subjekat/Subjekt: | | | | Data: Datum: Date: | 22.04.2024 |
| Nr. i Zyrës Br.Kancelarije Room.Nr | | Lokacioni Lokacija Extencion | | | |
| Për aktivitet/Za aktivnost/For action | | | | | |
| Për miratim/Za usvaja nje/For aprovao | | | | | |
| Për nënshkrim/Za potpis/For signature | | | | | |
| Për komente/Za komentare/For koments | | | | | |
| A mund të diskutojm/Da li mozemo raspravljati/May we discuss/ | | | | | |
| Vëmendja e juaj/ Vasa Paznja/Your attention/ | | | | | |
| Sipas diskutimit/Kako je raspravljeno/As discussed/ | | | | | x |
| Siqë është kërkuar/kako je zatrazeno/As resquested/ | | | | | x |
| Shënim dhe përgjigje/Beleska i odgovor/Note and retur/ | | | | | |
| Për informimin tuaj/ Za vasu informaciju/For your information/ | | | | | |
| Afati/Rok/ Deadline/ | | | | | |

I/E Nderuar

Drejtoria për KGJP-si ka pranuar sot me sh 07 nr. proet.12570 nr. faqe 1 te datës 19.04.2024 . ku kërkesës i mungon projekti .

Bazuar ne shkresën e kërkuar për pajisje me dokumentacion për parcelën me Nr.P-71107041 – 01985-0 me sipërfaqe 6208 m2 zona kadastrale Kamenicë Komuna e Kamenicës ,me pronar Komuna e Kamenicës , lloji i shfrytëzimit Tok Ndërtimore , shfrytëzimi aktual Trull , kualiteti Klasa e..

Fleta poseduese me nr.ref 873/2024 te datës 22.04.2024 e përanditur nga z. V. Dalipi.

Si dhe kopjen e planit te punuar nga Gjeodeti J. Rrustemi

Ju mund te shihni dokumentin e kërkuar ku ju bashkëngjisim kësaj shkrese.

Me respekt F Hoti.

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71107041-01985-0

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | 873/2024 |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 22.04.2024 - 08:33 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | KAMENICË / KAMENICA / KAMENICË |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | Kamenicë / Kamenica / Kamenicë |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | KAMENICË / KAMENICA / KAMENICË |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **P-71107041-01985-0** | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Urban | **6208** | ndarje parcele me vendim K.K.Kamenic nr.1693 date 02-05-12, 124-2003, 117-2004, 1-92, 42-2004, 12-2003, 32-2004, 13-2003, 11-2003, 104-2003, 5-90, 7-90,KERKESE PER BASHKIM, NR.flet.parqitjes 03/2015, e dat.03.04.2015.KERKES PER PARCELIM,NR.flet.parqitjes 03/2015, e dat.03.04.2015. | 21.04.2015 | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| QENDRA TREGTARE ZEJTARE | | | 21.04.2015 | |

REPUBLIKA KOSOVA, OPŠTINA KAMENICA, KOMUNA E KAMENICËS, DREJTORIA E GJEODEZISË DHE PRONËSISË

**Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person**

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri Broj Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use | Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class | Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 4 | Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemljište/Construction land | Truall/Zemliste/Land | | 6208 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat Prava Rights | Emri Ime Name | Nr. personal Licni broj ID. No. | Vendbanimi Prebivaliste Resident | Kodi postal Poštanski kod Postal code | Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address details | Pjesa e pronës Deo imovine Share quota | Pershkrimi Opis Description | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | **Komuna e Kamenicës** | 600535390 | / / / | | SKËNDERBEU | **1/1** | | 22.04.2015 |

**Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

# KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAMENICË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kamenicë

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-71107041-01985-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 6208 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:736

Punoi/Obradio/Created: Jashar

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 22.04.2024

Koha/ Vreme/ Time: 08:37:06

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 14956
Nr. i faq. 2 Data: Datum: 10/05
KAMENICË/A 2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 10.05.2024**

Bazuar në nenin 12 pika 12.2 shkronja d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-092/2019 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, nenin 17 të Rregullores së QRK Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 38 paragrafi 38.2), të Statutit Sh.01 Nr.20203 dt.21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 29.04.2024 miratoi këtë:

# VENDIM

## PËR FORMIM TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS PËRMES ANKANDIT PUBLIK

1. Me këtë Propozim - Vendim paraprak formohet komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatëshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.

2. Komisioni nga pika 1 (një) e këtij vendimi ka këtë përbërje:

   **2.1.** Lirim Kryeziu, anëtar i kuvendit
   **2.2.** Rabit Dërmaku, anëtar i kuvendit
   **2.3.** Ilirida Zubaku, nga ekzekutivi i komunës
   **2.4.** Edon Dërmaku, nga ekzekutivi i komunës, dhe
   **2.5.** Sherafedin Vranja, nga sektori joqeveritar lokal.

3. Ky Komision formohet për dhënien në shfrytëzim e pronës së paluajtëshme të Komunës së Kamenicës, në shfrytëzim afatshkurtër përsonave fizik dhe juridik si në vijim:

   **3.1.** Njësia kadastrale me nr. P-71107063-00292-0, vendi i quajtur, Kodra e Makovishte me sipërfaqe prej 82696 m$^2$, në zonën kadastrale në Poliçkë, Komuna e Kamenicës.

   **3.2.** Njësia kadastrale me nr. P-71107063-00342-0, vendi i quajtur, Kodra e Makovishte me sipërfaqe prej 47993 m$^2$, në zonën kadastrale në Poliçkë, Komuna e Kamenicës.

4. Afati kohorë për dhënjen në shfrytëzim të pronës së palujtshme Komunale është afatshkurtër me kohëzgjatje prej 5 viteve.

5. Anëtarët e komisionit me shumicë të votave zgjedhin Kryesuesin e Komisionit, i cili kryeson punën e komisionit.

6. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën (2) dy të këtij Vendimi, përgjegjësitë dhe kompetencat do ti ushtroj në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-092 për për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës dhe Rregullores së QRK Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

7. Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës që të zhvilloj procedurat për shpalljen e Ankandit, si dhe Drejtoria për Pronë Gjeodezi dhe Kadastër të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimin e kontratës pas lidhjes së sajë.

8. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës dhe anëtarët e Komisionit.

9. Ky Vendim hyn në fuqi (7) shtatë ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Kamenicës.

***Vendimi t'i dërgohet**: Zyrës së Kryetarit,Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Anëtarëve të Komisionit, MAPL-së dhe QSHQ- arkiv.*

Liridon KASTRATI

Kryesues i Kuvendit të Kamenicës

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYT...
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 14948
Nr. i faq. 2 Data: Datum: 10/05
KAMENICË/A 2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 10.05.2024**

Bazuar në nenin 12 pika 12.2 shkronja d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-092/2019 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, nenin 17 të Rregullores së QRK Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 38 paragrafi 38.2), të Statutit Sh.01 Nr.20203 dt.21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 29.04.2024 miratoi këtë:

# V E N D I M

## PËR FORMIM TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS PËRMES ANKANDIT PUBLIK

**1.** Me këtë Vendim formohet komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatëshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.

**2.** Komisioni nga pika 1 (një) e këtij vendimi ka këtë përbërje:

**2.1.** Hasan Krasniqi, anëtar i kuvendit
**2.2.** Florim Kryeziu, anëtar i kuvendit
**2.3.** Ilirida Zubaku, nga ekzekutivi i komunës
**2.4.** Edon Dërmaku, nga ekzekutivi i komunës, dhe
**2.5.** Sherafedin Vranja, nga sektori joqeveritar lokal.

**3.** Ky Komision formohet për dhënien në shfrytëzim e pronës së paluajtëshme të Komunës së Kamenicës, në shfrytëzim afatshkurtër përsonave fizik dhe juridik si në vijim:
Njësia kadastrale me nr. . P-71107041-01985-0, vendi i quajtur, Qendra Tregtare Zejtare me sipërfaqe prej 6208 m$^2$, në zonën kadastrale në Kamenicë, Komuna e Kamenicës.

**4.** Nga Parcela e cekur në pikën **3** të këtij Vendimi, jepen në shfrytëzim S - 85 m$^2$.

**4.** Afati kohorë për dhënjen në shfrytëzim të pronës së palujtshme Komunale është afatshkurtër me kohëzgjatje prej 15 viteve.

**5.** Anëtarët e komisionit me shumicë të votave zgjedhin Kryesuesin e Komisionit, i cili kryeson punën e komisionit.

**6.** Komisioni në përbërje të cekur si në pikën (2) dy të këtij Vendimi, përgjegjësitë dhe kompetencat do ti ushtroj në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-092 për për Dhënien në

shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës dhe Rregullores së QRK Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

7. Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës që të zhvilloj procedurat për shpalljen e Ankandit, si dhe Drejtoria për Pronë Gjeodezi dhe Kadastër të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimin e kontratës pas lidhjes së sajë.

8. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës dhe anëtarët e Komisionit.

9. Ky Vendim hyn në fuqi (7) shtatë ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Kamenicës.

***Vendimi t'i dërgohet**: Zyrës së Kryetarit,Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Anëtarëve të Komisionit, MAPL-së dhe QSHQ- arkiv.*

Liridon KASTRATI

Kryesues i Kuvendit të Kamenicës

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E KAMENICËS OPŠTINA KAMENICA 01 KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVO
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 14962
Nr. i faq. Br. str. 5 Data: Datum: 10/05
KAMENICË/A 2024

**Kuvendi Komunal-Kamenicë**
**Më: 10.05.2024**

Në bazë të nenit 12 , paragrafi 12.2, pika d), nenit 17 pika (b), neni 40 shkronja (l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28 qershor 2008);, Nenit 5 Paragrafi 1 , nënparagrafi 1.2 pika 1.2.2, Neni 10 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 Neni 11 paragrafi 1.3, Nenit 16 dhe nenit 26 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174, datës 31.07.2013, Udhëzimit Administrativ neni Nr. 11/ 2015, Mbi elementet dhe kerkesat për Hartimin , Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal, neni 38 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 29.04.2024 miratoi këtë:

# V E N D I M

## PËR HARTIMIN E HARTËS ZONALE TË KOMUNËS SË KAMENICËS

### Neni 1

### Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

**Miratohet vendim fillimin e hartimit Hartës Zonale të Komunës së Kamenicës**

### Neni 2

### Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Harta zonale e komunës, është një dokument shumë sektorial,që përmes grafikoneve,fotografive, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin , shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit, të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e komunës, për periudhën së tetë (8) vjeçare.

### Neni 3

### Qëllimi i hartimit

Me Hartën zonale të Komunes, nga neni 1 i këtij vendimi , përcaktohen kushtet zhvillimore dhe kushtet ndërtimore për zonat urbane dhe rurale, në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësit për të arritur kushte optimale të rregullimit dhe ndërtimit në komunën e Kamenicës, plotëson kërkesat ligjore për rregullimin e zhvillimeve në zonën urbane dhe rurale .

## Neni 4

### Kufiri i territorit

Territori i Komunës së Kamenicës ndahet në **58** zona kadastrale, me sipërfaqe prej **(S = 4166323,74 m²) S =416,624 km²,** zonat kadastrale në territorin e Komunës së Kamenicës:

| ZONA KADASTRALE | KADASTRAL 1 | Sipërfaqja m² | Sip_Hektar/ Ha |
|---|---|---|---|
| 71107002 | Hajnovc | 137310.64 | 13.731064 |
| 71107003 | Berivojcë | 81154.21 | 8.115421 |
| 71107004 | Bllatë | 11866.28 | 1.186628 |
| 71107007 | Boscë | 44194.54 | 4.419454 |
| 71107008 | Bratilloc | 43498.85 | 4.349885 |
| 71107009 | Busavatë | 106538.14 | 10.653814 |
| 71107079 | Çarakoc | 37074.95 | 3.707495 |
| 71107026 | Dajkoc | 31275.60 | 3.12756 |
| 71107025 | Dazhnicë | 41417.60 | 4.14176 |
| 71107027 | Desivojcë | 161425.03 | 16.142503 |
| 71107035 | Gjyrishec | 89117.19 | 8.911719 |
| 71107031 | Shipashnica i Ultë | 38264.94 | 3.826494 |
| 71107032 | Karaçevë i Ultë | 43227.78 | 4.322778 |
| 71107077 | Feriqevë | 63582.35 | 6.358235 |
| 71107016 | Gmicë | 121273.29 | 12.127329 |
| 71107019 | Shipashnica e Epërme | 94090.59 | 9.409059 |
| 71107021 | Karaçevë i Epërm | 112683.39 | 11.268339 |
| 71107022 | Gragjenik | 60328.26 | 6.032826 |
| 71107023 | Grizimë | 40923.23 | 4.092323 |
| 71107038 | Kolloleq | 81290.88 | 8.129088 |
| 71107039 | Kopërnicë | 83334.22 | 8.333422 |
| 71107040 | Koretin | 112723.70 | 11.27237 |
| 71107041 | Kamenicë | 70102.37 | 7.010237 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 71107042 | Kostadincë | 52609.93 | 5.260993 |
| 71107043 | Kranidel | 98557.69 | 9.855769 |
| 71107044 | Kremenata I | 68862.85 | 6.886285 |
| 71107045 | Kremenata II | 21600.81 | 2.160081 |
| 71107046 | Krilevë | 168570.95 | 16.857095 |
| 71107047 | Lisockë | 79514.36 | 7.951436 |
| 71107048 | Lajçiq | 91891.53 | 9.189153 |
| 71107049 | Leshtar | 49086.60 | 4.90866 |
| 71107051 | Marocë | 22758.42 | 2.275842 |
| 71107052 | Meshinë | 80729.84 | 8.072984 |
| 71107054 | Moçar | 62999.30 | 6.29993 |
| 71107055 | Muçivërc | 70852.87 | 7.085287 |
| 71107056 | Novosellë | 15282.16 | 1.528216 |
| 71107058 | Hodonoc | 148133.30 | 14.81333 |
| 71107057 | Hogosht | 154733.78 | 15.473378 |
| 71107060 | Rahovicë | 48175.08 | 4.817508 |
| 71107062 | Petroc | 36081.77 | 3.608177 |
| 71107063 | Poliçkë | 98130.91 | 9.813091 |
| 71107066 | Roboc | 37531.31 | 3.753131 |
| 71107067 | Rogaçicë | 115558.42 | 11.555842 |
| 71107080 | Shahiq | 15612.93 | 1.561293 |
| 71107069 | Sedllar | 56113.55 | 5.611355 |
| 71107071 | Strelicë | 27963.58 | 2.796358 |
| 71107070 | Strezoc | 80466.57 | 8.046657 |
| 71107068 | Svircë | 104812.46 | 10.481246 |
| 71107074 | Topanicë | 82388.59 | 8.238859 |
| 71107075 | Tërstenë | 99671.21 | 9.967121 |
| 71107076 | Tugjec | 137027.52 | 13.702752 |
| 71107011 | Vaganesh | 43941.95 | 4.394195 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 71107018 | Velegllavë e Epërme | 81517.53 | 8.151753 |
| 71107030 | Velegllavë e Ultë | 29689.61 | 2.968961 |
| 71107013 | Vriqec | 41818.14 | 4.181814 |
| 71107037 | Zajçec | 84072.01 | 8.407201 |
| 71107036 | Zhujë | 29371.94 | 2.937194 |
| 71107017 | **Gogolloc** | 23496.24 | 2.349624 |
| | | TOTALI ne Ha: | 416.632374 |

**Neni 5**

**Subjekti përgjegjës për zbatim**

Bartës i hartimit të Hartës Zonale të Komunës caktohet **Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor.**

**Neni 6**

**Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim**

Mjetet për hartimin e Hartës Zonale të Komunës sigurohen nga buxheti i Komunës së .
Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor koordinon procesin e hartimit të Hartës Zonale të Komunës me drejtoritë sektoriale dhe burimet njerëzore brenda komunës. apo Harta zonale e Komunës hartohet në bazë të kontratës të lidhur në mes të Komunës së Kamenicës dhe kontraktorit të przgjedhur nga konkursi i projektimit përmes procedurave të prokurimit publik sipas Ligjit Nr. 03/ L-241 Për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

(definohet a hartohet me konkurs te projektimit apo vetem nga komuna)

**Neni 7**

**Afati i hartimit**

Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinore sipas nenit 1 të këtij propozim vendimi është i obliguar që Hartën Zonale të Komunës ta hartojë në afat prej 9 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Propozim-vendimi.

**Neni 8**

**Konsultimet publike**

Para finalizimit të projektit për Hartimin e Hartës Zonale, ai duhet të vihet në konsultime publike dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e HZK në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen përmes njoftimeve publike.

**Neni 9**

**Afati i vlefshmërisë**

Harta Zonale e Komunës , hartohet për periudhën kohore tetë (8) vjeçare.

**Neni 10**

**Gjuhet zyrtare**

Dokumenti i planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi duhet të jetë në gjuhët zyrtare të komunës dhe së paku në 3 (kopje) të shtypura e të vulosura dhe (3) kopje digital të origjinalit .

**Neni 11**

**Programi**

Pjesë e këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit i paraparë me nenin 11 pika 1.3 të Ligjit për Planifikim Hapësinorë Nr. 04/L-174.

**Neni 12**

**Hyrja në fuqi**

Me miratimin nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky Vendim hynë në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, Nr-03-L- 040 dhe publikimi në web-faqen Zyrtare të Komunës.

***Vendimi t'i dërgohet**: Zyrës së Kryetarit,Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, MAPL-së dhe QSHQ- arkiv.*

Liridon KASTRATI

Kryesues i Kuvendit të Kamenicës

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS...
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY...
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 06 Nr. Br. 13328
Nr. i faq. Br. str. 3 Data: Datum: 25/04
KAMENICË/A 2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

## Drejtoria për Kadastër ,Gjeodezi dhe Pronësi

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| REFERENC-Ë: | | | SH.Z nr 02-07-048/2024 | | |
| PËR/ZA/TO: | | | Drejtoria e Urbanizmit Drejtor. Uran Berisha | | |
| CC: | | | Zyrtari i lartë Ligjor Arif Skovergani | | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | | | Drejtor-KGJP-si **Diana Ajvazi** | | |
| NGA/OD/FROM: | | | **Z.L Shef-** DKGJP-si **Fadil Hoti** | | |
| TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT: | | | Përgjigjeje | | |
| Nr. i Zyrës:<br>Br. Kancelarije:<br>Room No: | | Lokacioni:<br>Lokacija:<br>Extencion: | Objekti i Komunës | | **25.04.2024** |

| | |
|---|---|
| Për aktivitet/Za aktivnost/For action. | |
| Për miratim/Za usvajanje/For aprovao. | |
| Për nënshkrim/Za potpis/ For signature. | |
| Për komente/Za komentare/For comments. | |
| A mund të diskutojmë/Dali možemo raspravljati/ May we discuss. | |
| Vëmendja e juaj/ Vaša pažnja/Your attention. | |
| Sipas diskutimit/Kako je raspravljeno/As discussed. | |
| Siç është kërkuar/ Kako je zatraženo/As requested. | X |
| Shënim dhe përgjigje/ Beleška i odgovor/ Note and retur. | X |
| Për informimin tuaj/ Za vašu informaciju/ For your information. | x |
| Afati/ Rok/Deadline/. | |

I nderuar

Drejtoria për KGJP-si ka pranuar kërkesën nga DUPH me nr. Pro. Sh.7 nr13000 nr.faq.1 te datës 23.04.2024 pas shqyrtimit te kërkesës tuaj ne kontrolluam sistemin Kadastral ku ju japim ketë përgjigjeje ku ju mund te shihni te bashkangjitur kësaj shkrese .
Me respekt F.Hoti

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

# Drejtoria për Pronësi, Kadastër dhe Gjeodezi

*Nga : Zl.Shef. Fadil Hoti DKGJP-si*

*Komuna e Kamenicës është e përbërë prej **58** zonave kadastër ale ,Ku nga 51 prej tyre kemi sipërfaqe me pronë komunale( kullosa) dhe një sipërfaqe tjetër te mbuluara me pyje te cilat janë prona të komunës të menegjuara nga Agjencinë Pyjor I Kosovës ( APK)si dhe një pjesë e saj nga Agjencia Kosovare e Privatizimit ( AKP:*

*Nga sipërfaqja e tërësishme e këtyre **58** zonave kadastër ale kemi **41663,23,74 ha**, (Katër dhjet e një mi e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre hektar e njëzet e tre ari e shtatëdhjetë e katër metra).*



Harta e re e Komunës së Kamenicës

| Regjistri për zonat Kadastrale | | | |
|---|---|---|---|
| **Nr.** | Nr Zonës | Zona kadastrale | Sipërfaqja |
| **01** | 71107002 | Hajnoc | 1373,10,64 |
| **02** | 71107003 | Berivojcë | 811,54,21 |
| **03** | 71107004 | Bllatë | 118,66,28 |
| **04** | 71107007 | Huboc (Bosce) | 441,94,54 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **48** | 71107067 | Rogoçicë | 1155,58,42 |
| **49** | 71107068 | Cfircë | 1048,12,46 |
| **50** | 71107069 | Sedllar | 561,13,55 |
| **51** | 71107070 | Strezoc | 804,66,57 |
| **52** | 71107071 | Stralicë | 279,63,58 |
| **53** | 71107074 | Topanicë | 823,88,59 |
| **54** | 71107075 | Tërstenë | 996,71,21 |
| **55** | 71107076 | Tugjefc | 1370,27,52 |
| **56** | 71107077 | Firiqejë | 635,82,35 |
| **57** | 71107079 | Çarakofcë | 370,74,95 |
| **58** | 71107080 | Shahiq | 156,12,93 |
| **Sipërfaqja e përgjithshme** | | | **41663,23,74** |

# PROGRAMI PËR HARTIMIN DHE MENAXHIMIN E HARTËS ZONALE TË KOMUNËS

| I | Punët Parapërgatitore | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Detyrat | Aktivitetet | Qëllimi | Kohëzgjatja Javë | Përgjegjës |
| 1 | Përcaktimi i Grupit Punues | Përcaktimi i udhëheqësit komunal të projektit dhe Grupit punues. | Përcaktimi i Grupit Punues. | 1 | Kryetari i Komunës |
| 2 | Përcaktimi i grupeve të interesit | 2.1) Përcaktimi i grupeve lokale të interesit<br>- institucionet në nivelin qendror;<br>- Organizatat e Jashtme që ofrojnë shërbime publike;<br>- OJQ;<br>- Biznese;<br>-Përfaqësues nga Bashkësitë Lokale.<br>2.2) Krijimi i listës dhe kontakteve të pjesëmarrësve. | Në mënyrë që procesi të jetë sa më transparent dhe gjithëpërfshirës. | 1 | Udhëheqësi Komunal i Projektit |
| 3 | Hartimi i konceptit dhe planit të punës | 3.1) Shqyrtimi i Legjislacionit në fuqi për HZK;<br>3.2) identifikimi i rreziqeve dhe kërcënimeve;<br>3.3) Krijimi i strukturës përmbajtjesore;<br>3.5) Prezantimi i strukturës së dokumentit dhe konceptit të punës para drejtorive komunale. | Koordinimi i qëndrueshëm i drejtorive komunale, Plani i hollësishëm i punës gjatë procedurës së hartimit të HZK'së. | 1 | Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës |
| 4 | Zhvillimi i takimeve njoftuese me banorët | 4.1) Takime njoftuese me banorë të zonës urban dhe Grupin Punues;<br>4.2)Takime njoftuese me banorë të zonës rurale dhe Grupin Punues. | Njoftimi transparent dhe gjithëpërfshirës. | 1 | Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës |

| II | Konsolidimi i të Dhënave të Dokumenteve Ekzistuese të Planifikimit Hapësinor | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Detyrat | Aktivitetet | Qëllimi | Kohëzgjatja Javë | Përgjegjës |
| 1 | Konsolidimi i të dhënave hartografike | Konsolidimi i të dhënave hartografike nga PZHU, PRRU-të. | Përmbushja e kërkesave të kërkuara nga UA për HZK. | 2 | Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës |

REPUBLIKA E KOSOVËS * KUVENDI KOMUNAL KAMENICË * DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR 06

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 2 | Konsolidimi i kushteve zhvillimore dhe kushteve ndërtimore ekzistuese | Konsolidimi i të dhënave hartografike nga PZHU, PRRU-të. | Përmbushja e kërkesave të kërkuara nga UA për HZK. | 2 | Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës |
| 3 | Shqyrtimi i ankesave, të parashtruara nga qytetarët nga viti 2015-2018 për planet ekzistuese | Formimi i Komisionit. | Për një planifikim të qëndrueshëm. | 2 | Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe Komisioni Shqyrtues |

| III | **Identifikim i të Dhënave Shtesë që Duhet të Përpunohen** | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Detyrat** | **Aktivitetet** | **Qëllimi** | **Kohëzgjatja Javë** | **Përgjegjës** |
| 1 | Vlerësimi i Përshtatshmërisë dhe përputhshmërisë së Kushteve Zhvillimore dhe Kushteve Ndërtimore ekzistuese me nevojat dhe HZK-në e miratuar | 1.1) Vlerësimi profesional;<br>1.2) Përgatitja e prezantimit dhe raporti vlerësues, duke përfshirë përcaktimin e kushteve shtesë që duhet të përgatiten në përputhje me UA për HZK;<br>1.3) Dorëzimi dhe prezantimi i raportit vlerësuese për grupi punues (GP). | Përpunimi sipas kërkesave të UA për HZK. | 2 | Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetëse |
| 2 | Inkorporomi i sugjerimeve për të dhëna shtesë nga GP | Plotësimi me të dhëna shtesë në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga GP. | Përmbushja e kërkesave të përcaktuara sipas UA për HZK. | 2 | Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës |

| IV | Përgatitja e Kushteve të Përgjithshme Zhvillimore | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Detyrat | Aktivitetet | Qëllimi | Kohëzgjatja Javë | Përgjegjës |
| 1 | Përgatitja e kushteve të përgjithshme zhvillimore | 1.1) Përpilimi i kushteve të përgjithshme zhvillimore, të cilat janë të zbatueshme për tërë territorin dhe shfrytëzimet e përcaktuar në HZK;<br>1.2) Përgatitja e prezantimit të kushteve të përgjithshme zhvillimore dhe hartave;<br>1.3)Dorëzimi dhe prezantimi i raportit vlerësues nga GP. | Kushtet e përgjithshme zhvillimore duhet të përcaktohen për tërësinë territoriale më të gjëra që përmbajnë kritere të ngjashme. | 3 | Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës |
| 2 | Inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë nga KD dhe GP | Plotësimi me të dhëna shtesë në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga GP. | Përmbushja e kërkesave të përcaktuara sipas UA për HZK. | 2 | Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës |
| 3 | Zhvillimi i prezantimit publik të kushteve të përgjithshme zhvillimore. | Prezantimit publik të kushteve të përgjithshme zhvillimore. | Njoftim i banorëve me kushtet e përgjithshme zhvillimore. | 1 | Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës |
| 4 | inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë nga banorët | Plotësimi me të dhëna shtesë në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga GP. | Përfshirja e kërkesave të qytetarëve në procesin e planifikimit. | 1 | Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe Sektori për Mjedis |

| V | Përgatitja e Kushteve Zhvillimore dhe Kushteve Ndërtimore | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Detyrat | Aktivitetet | Qëllimi | Kohëzgjatja Javë | Përgjegjës |
| 1 | Përgatitja e Kushteve Zhvillimore dhe hartave për kushtet specifike | 1.1) Përpilimi i kushteve zhvillimorepër zonat e caktuara specifike tekstualisht dhe grafikisht;<br>1.2) Përgatitja e prezantimit të kushteve zhvillimore teksualisht dhe grafikisht;<br>1.3) Dorëzimi dhe prezantimit i kushteve zhvillimore për GP. | Trajtim i veçantë për këto zona. | 4 | Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës |
| 2 | Përgatitja e Kushteve ndërtimore dhe hartave për zonat e përcaktuara për ndërtim | 2.1) Përpilimi i kushteve ndërtimore për zonat e përcaktuara për ndërtim;<br>2.1) Përgatitja e prezantimit të kushteve ndërtimore teksualisht dhe grafikisht;<br>2.3) Dorëzimi dhe prezantimit i kushteve ndërtimore për GP. | Përmbushja e kërkesave të përcaktuara sipas UA për HZK. | 4 | Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës |
| 3 | Inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë nga GP | Plotësimi me të dhëna shtesë në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga GP. | Përmbushja e kërkesave të përcaktuara sipas UA për HZK. | 1 | Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës |
| 4 | Zhvillimi i prezantimit publik të kushteve zhvillimore dhe kushteve ndërtimore | 4.1) Prezantimit publik për banorët e zonës urban;<br>4.1) Prezantimit publik për banorët e zonës rurale. | Njoftim i banorëve me kushtet e përgjithshme zhvillimore. | 1 | Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës |
| 5 | inkorporimi i sugjerimeve nga banorët | Plotësimi me të dhëna shtesë në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga GP. | Përfshirja e kërkesave të qytetarëve në procesin e planifikimit. | 1 | Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës |

REPUBLIKA E KOSOVËS * KUVENDI KOMUNAL KAMENICË * DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR * 06

| VI | Përgatitja e Zonave Mbishtresore dhe Kushteve Zhvillimore | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Detyrat | Aktivitetet | Qëllimi | Kohëzgjatja Javë | Përgjegjës |
| 1 | Përgatitja e Zonave Mbishtresore dhe Kushteve Zhvillimore | 1.1) Përpilimi i zonave mbishtresore, kushteve zhvillimore tekstualisht dhe grafikisht;<br>1.2) Përgatitja e prezantimit për zonat mbishtresore, kushteve zhvillimore tekstualisht dhe grafikisht;<br>1.3) Dorëzimi dhe prezantimi i zonave mbishtresore, kushteve zhvillimore për GP. | Përmbushja e kërkesave të përcaktuara sipas UA për HZK. | 4 | Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës |
| 2 | Inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë nga GP | Plotësimi me të dhëna shtesë në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga GP. | Përmbushja e kërkesave të përcaktuara sipas UA për HZK. | 2 | Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës |
| 4 | Zhvillimi i prezantimit publik të Zonave Mbishtresore dhe Kushteve Zhvillimore | 4.1) Prezantimit publik për banorët e zonës urban;<br>4.2) Prezantimit publik për banorët e zonës rurale. | Njoftim i banorëve me kushtet zhvillimore. | 1 | Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës |
| 5 | Inkorporimi i sugjerimeve nga banorët | Plotësimi me të dhëna shtesë në rast se kjo vlerësohet e nevojshme nga GP . | Përfshirja e kërkesave të qytetarëve në procesin e planifikimit. | 1 | Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës |

| VII | Përgatitja e Kushteve Zhvillimore për Infrastrukturë Teknike | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Detyrat | Aktivitetet | Qëllimi | Kohëzgjatja Javë | Përgjegjës |
| 1 | Përgatitja e kushteve zhvillimore për infrastrukturë teknike | 1.1) Përpilimi i kushteve zhvillimore për infrastrukturë teknike - pjesa tekstuale dhe grafike;<br>1.2) Përgatitja e prezantimit të kushteve zhvillimore për infrastrukturë teknike;<br>1.3) Dorëzimi dhe prezantimi i kushteve zhvillimore për infrastrukturë teknike për GP . | Përmbushja e kërkesave të përcaktuara sipas UA për HZK. | 3 | Udhëheqësi Komunal i Projektit dhe ekipi konsulent/mbështetës |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
